

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.03.2025*

05.03.2025

Ora 11:10

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprakë i kërkesës ankimore nr.4, me ankues Partia Aleanca Europiane Ekologjike –AEE. Me objekt: Ndryshimin e vendimit nr.230, datë 28.02.2025 të KSHZ për miratimin e elementëve përmbajtësor të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako (online), z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj , Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PAEE.
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. L. Braho: Çelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe të përmbatjes të kërkesës ankimore nr. 4. Në datë 03.03.2025 pranë KQZ-së është protokolluar kjo kërkesë ankimore me ankues Partia Aleanca Europiane Ekologjike, me kryetar zotin Sazan Guri, me objekt ndryshimin e vendimit nr.230 dt. 28.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e elementëve përmbajtësor të fletës së votimit të shpallur në datën e seancës të datës 28.02.2025. Atëherë si fikllim seanca sot është vetëm për elementët e formës dhe të përmbatjes pra nuk do i hymë themelit të ankimit të ankuesve. Të pranishëm janë përfaqësues të ankuesit ju lutem për efekt procesverbali prezantohuni.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.03.2025*

Z. Altin Goxhaj përfaqësues ligjor i PAEE: Kam paraqitur edhe autorizimin, e datës 1 Mars që lidhet edhe me çështjet e ankimimit bashkangjitur bashkë me ankimin dhe kam edhe të drejtën për tu përfaqësues edhe me autorizimin që të ndaj përfaqësimin tim edhe me përfaqësues të tjerë siç kam zgjedhur një studio ligjore Meksi Laë and Consulting, e cila është studio që na ka ndihmuar për të bërë këtë ankim.

Z. L. Braho: Të lutëm edhe një prezantim edhe të avokatëve.

Av. Ilir Gërdupi

Av. Redon Meksi

Z. L. Braho: Po ashtu e pranishme është edhe administrata e KQZ-së. Atëherë shkurtimisht në fillim ia japim fjalën administratës vetëm për sa i përket elementëve të formës dhe të përmbajtjes.

Znj. I. Osmanaj: Faleminderit! Atëherë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit 230 datë 28.02.2025 ka miratuar vendimin për disa element përmbajtësor të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.05.2025, kundër këtij vendimi ka depozituar ankim rregjistruar me numër protokolli 1545 datë 03.03.2025 Partia Aleanca Europiane Ekologjike me kryetar zotin Sazan Guri. Objekti i këtij ankimi është ndryshimi i vendimit nr.230 dt 28.02. 2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit shpallur në seancën e datës 28 Shkurt 2025. Nga verifikimi i elementëve të kësaj kërkesë ankimore, konstatojmë që vetëm elementi i formës pra

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.03.2025*

nuk është në përputhje me formën e përcaktuar me vendim të Komisionit Rregullator për pjesën tjetër është në rregull. Gjithësesi e lëmë në çmimin e KAS për të dhënë vlerësim për këtë gjë.

Z. L. Braho: Dakord! Fjala për përfaqësuesit e ankuesve. Kushdo që ka dëshirën mund të vijojë me këto element pra për formën dhe për afatin.

Z. Altin Goxhaj përfaqësues ligjor i PAEE: Ne kemi paraqitur një ankim bazuar në të gjithë kriteret e ligjit, kemi referuar nenin që jemi mbështetur, të drejtën tonë për ta bërë, legjitimitetin si parti politike. unë si përfaqësues i PAEE përfaqësues në komunikimin me KQZ-në i rregjistruar edhe në dokumentacionin e KQZ-së. Me datën 1 Mars me të drejta të plota edhe për të bërë ankime nga PAEE me firmë dhe me vulë nga ana e kryetarit të partisë zotit Sazan Guri. Po me të drejtën që më është dhënë po me këtë autorizim kam caktuar edhe studion ligjore në mbështetje dhe në përfaqësim të plotë në rastin konkret studio Mexsi Law and Consulting. Kemi paraqitur një ankesë që ka referuar bazën ligjore në të cilën është mbështetur. Të drejtat tona që kemi për ta bërë këtë gjë, jemi legjitim sepse jemi parti e rregjistruar në KQZ edhe si subjekt zgjedhor edhe si pjesë e një koalicioni zgjedhor. Me gjithë të drejtat e përfaqësive nga të drejtat legjitime të qenit në kandidim për faktin se kjo fletë votimi me këto numra i kanë të drejtë vetëm partitë e koalicionit e ka të përcaktuar qartë që kur ti voton për një kandidat në listë të hapur shumë emërore që është përfaqësues i koalicionit, numri i votive që janë marrë reflektohen edhe në partinë e tij të përfaqësuar. Pra, kemi edhe të drejta që janë cënuar nga ky vendim që ka marrë KQZ në të njëjtën logjikë edhe në formën e shkruar edhe në formën e përmbatjes ky është një ankim i rregullt sipas Kodit të Procedurave Administrative. Në aspektin kohor sipas ligjit, jemi brenda afateve sipas Kodit të Procedurës

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.03.2025*

Administrative koha 24 orë, është koha e një dite. Dita numërohet të nesërmen, po ashtu i referohemi faktit që ka qenë data e Premte, e Shtunë e Diel dhe mbetet e Hëna. Tani çfarë ndodh me datë 28 dhe çfarë ndodh me dt 3 Mars, unë kam korrespondencën zyrtare, të rregjistruar me drejtoreshën juridike të KQZ me të cilën kam kërkuar që të bohet vendimi se nuk ka qenë i botuar. Madje edhe sot që ne po flasim ne kemi një ankim tjetër në lidhje me votimin elektronik edhe ende nuk është botuar votimi i datës 28 në faqen zyrtare. Ne i kemi referuar facebook si informacion po ne nuk vijmë për të kundërshtuar facebook sepse nuk kemi në kohën e pandemisë që dilnin vendimet e qeverisë në facebook. Jemi në një procedurë të rregullt që i gëzon të gjitha kushtet dhe mundësitë KQZ për të përdorur një portal i cili është një portal që ka të bëjë me fletoren zyrtare. Në këtë kuadër i referohem edhe datës dhe orës gjithë korrespondencën që kam pasur me zonjën Pavlina, vendimi ka dalë pas orës siç del këtu 15:58 e ditës së Hënë. Ditën e Hënë ne kemi sjellë ankimin brenda afatit duke i referuar fillimisht njoftimet në facebook dhe më pas pasi është botuar në 15:58 kemi shtuar në materialin që po përgatishim edhe vendimin e plotë të referuar pikërisht në atë që është botuar në fletoren zyrtare. Ky fakt është një çështje që unë e mendoj që KAS duhet ta shqyrtojë edhe pjesën e botimeve e botimit mos botimit se kjo po ndikon në ankime. Kjo po ndikon shumë në mos informim në mos njohje, fakti që këto çështje 4 vjet më parë, ku është trajtuar e njëjta gjë, e njëjta histori. Kanë qenë të gjitha partitë e interesuara dhe këtë herë jemi vetëm ne nuk ka të bëjë me faktin që është çështje pa interes por nuk ka informacion. Të vetmit që patën informacion brenda afatit për shkaqe rastesore sepse ndodheshin për të rregjistruar PAEE në KQZ ku u mor edhe vendimi i datës 28 qëllon rastësisht në rend dite një çast pasi u trajtua kjo çështje dhe aty kam qenë për kundërshtimin. Pra, fakti që nuk ka informacion, nuk botohen gjërat, krijon një problem të madh që duhet të trajtohet edhe nga KAS si fenomen që të jepet një vendim njëherë e përgjithmonë edhe për

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.03.2025*

botimet edhe për afatet. Që të jetë e qartë që kur hynë në fuqi një afat që të vënë në punë edhe ata që janë administratë zgjedhore. Në këtë logjikë ne besojmë se kemi plotësuar të gjitha kriteret sipas Kodit të Procedurës Administrative, sipas Kodit Zgjedhor, afatet palët janë legjitime, ne jemi përfaqësues legjitim, kjo është një ankim i rregullt. Nuk besoj që ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar. Faleminderit!

Z. L. Braho: Tani neni 124 ka pësuar një ndryshim. Unë kam një pyetje për administratën e KQZ, në vitin 2021 ka pasur vendimmarrje të tillë përpara se të miratohej fleta, elementët përmbajtësor?

Znj. I. Osmanaj: Më duhet ta verifikojë sepse me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor gjykoj që është futur në zgjedhje tani. Megjithatë më duhet ta verifikojë për tui dhënë një përgjigje përfundimtare në lidhje me zgjedhjet 2021.

Z. L. Braho: Se neni 97 dhe 98 nuk ka ndryshuar janë po të njëjtët si në vitin 2021. Ideja është që 124 është përfshirë që për fletën e votimit afati i ankimit është 24 orë. Tani logjika e do që Komisioneri do të marrë vendim tjetër pasi do të depozitohen listat që do jenë fletët. Tani 124 përfshinë këtë, përfshinë fletën, i përfshinë të dyja?

Znj. I. Osmanaj: Tek dispozita e nenit 124 në lidhje me vendimin që ka miratuar Komisioneri është vendosur afati 3 ditor për shkak se është vendimi i parë i cili do të pasohet me vendimin e dytë i cili ka të bëjë me përmbajtjen e fletës së votimit. Këtu janë vetëm elementët përmbajtësor dhe do ketë një vendimmarrje tjetër më pas e cila do jetë në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit. Do ketë vendimmarrje tjetër.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.03.2025*

Z. L. Braho: Në qoftë se i referohemi këtyre elementëve këtu as subjekteve zgjedhore nuk kanë numra.

Znj. I. Osmanaj: Jo, do ketë një vendimmarrje tjetër.

Z. E. Çefa: Kam edhe një pyetje a mos vallë do të thotë kjo ndarja nga Komisioneri në dy faza e këtij procesi a mos do të thotë që eventualisht ekziston mundësia që në vendimin tjetër të na ndryshojnë përsëri këto elemente dhe ndoshta Komisioneri i fut numrat vetë kryesisht? Probabilisht ekziston si mundësi?! Mundet. Domethënë ky nuk është vendim detyrues në kuptimin që këtu u mbyll.


Znj. I. Osmanaj: Për aq kohë sa ky është një vendim i rregullt dhe ka një numër ka një datë, ka dispozitivin do të thotë që është një vendim i rregullt që do ...

Z. E. Çefa: Absolutisht në aspektin procedural. Pyetja është këtu, a mos vallë Komisioneri në marrjen e vendimit final le të themi për miratimin e fletës së votimit mundet eventualisht të ndryshojë elementë të caktuar dhe praktikisht edhe rregullimin po themi për çështjen për të cilën jemi mbledhur sot këtu në bazë të ankesës së subjektit ankimues? Këtë doja të dija.

Znj. I. Osmanaj: Në këtë fazë nuk mund ta themi dot.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.03.2025*

Z. L. Braho: Po këtë për numrin rendor që është pika 10. Numri rendor parti politike ose koalicioni i partive. Mund ta themi që do jetë nga numri 1 apo mund të jetë përshëmbull sin ë rastin e Kosovës nga numri 100. As këtë nuk e themi dot.

Znj. I. Osmanaj: Për momentin edhe këtë nuk e them dot. Por logjikisht do të fillonte me numrin 1

Z. L. Braho: Ka ndonjë pyetje tjetër? Trupa e kasit është në kourum të plotë. Zoti Lako është online, për pa mundësi objective për të qenë pranishëm këtu.

Z. Altin Goxhaj përfaqësues ligjor i PAEE: Doja ti kujtoja që për pyetjen e dy fazave. Unë e kam pyetur edhe e kam edhe me video edhe me audio në faqen zytrare të facebook të KQZ kur jepet transmetohet live që unë i kam thenë pikërisht zotit Celibashi që do vendosni numrin? Ka thënë që nuk do të vendos numrin. Pra, nuk është puna se nuk është momenti për të vendosur apo jo një numër është referuar jo. Nuk parashikohet të vendoset. Të sqarojmë këtë momentin që ka dy faza tre faza, ku vetë zoti Celibashi ka thënë jo. Është me video dhe me audio. Faleminderit! Është vendimi i kolegjit....

Z. L. Braho: Vendimi i Kolegjit është për specifikime teknike e mbaj mend nga debati që është bërë. Specifikimet teknike janë miratuar nga rregullatori që kishte përcaktuar edhe përmasat e fletës së votimit dhe pastaj ata shpallën mos kompetencën për fletën e votimit dhe e miratoi fletën Komisioneri që pastaj erdhi në KAS dhe më vonë shkoi në Kolegj Zgjedhor. Jo, Komisioni Rregullator e ka lënë që përmasat do ti përcaktojë Komisioneri për përmasat minimale e ka përcaktuar porn

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.03.2025*

ë varësi të subjekteve zgjedhore fleta mund të ndryshojë dhe do të mbetet kompetencë e Komisionerit.

Z. Altin Goxhaj përfaqësues ligjor i PAEE: Më fal i nderuar po të jetë i njëjti vendim i referohet qartësisht nevojës për numër ose jo. Dhe aty bëhet një qendrim i plotë për vendosjen e numrave apo jo. Pra, kemi një vendim të Kolegjit Zgjedhor i cili i referohet teksualisht numrit duhet apo jo vota parapëlqyese.

Z. L. Braho: Dakord, këto i takojnë themelit. KAS pas këshillimit vendosi që ta kalojë për shqyrtim, kërkesën ankimore nr.4 depozituar në KQZ në datë 03.03.2025. Caktimin e seancës për shqyrtimin administrativ në datë 7 Mars ora 10:30 dhe i kërkojmë administratës së KQZ që të njoftojë tësubjektet zgjedhore që janë të rregjistruar përfshirë këtu edhe koalicionet, meqenëse çështja e fletës së votimit ka interes për të gjitha palët. Kush e mendon që të jetë i pranishëm kjo është çështje tjetër. Po njoftimi ti bëhet të gjithë subjekteve zgjedhore. Seancën e deklaroi të mbyllur.

Vendimi nr. 11

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

